



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 53/2020

**KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË**, në mbështetje të Nenit 21, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Neni 31 paragrafi 1 me nënparagrafët 1.7 dhe 1.8, si dhe Nenin 32, paragrafin 1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 12, paragrafit 4 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në procedurë të votimit qarkullues të datës 30 korrik 2020, miraton këtë:

V E N D I M

- I. DHUROHEN mjetet financiare të dedikuara për familjet e mjekëve që kanë vdekur si pasojë e infektimit me virusin COVID-19, në shumë prej 1,000.00 € (me fjalë: një mijë euro) për secilën familje.
- II. Mjetet financiare nga paragrafi I i këtij vendimi do të sigurohen nga Buxheti i Odës së Mjekëve të Kosovës, dhe shpenzimet e tilla do të trajtohen si mjete financiare me prioritet.
- III. OBLIGOHET Zyra për Buxhet dhe Financa që të fillojë procedurat e nevojshme financiare për ekzekutimin e këtij vendimi sipas kushteve të parapara në të.
- IV. Procedurat e mëturshme do të zhvillohen në përputhje me dispozitat e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KËSHILLI DREJTUES I OMK-SË  
NR. I REF. 53/2020 dt.30 korrik 2020

Prishtinë, 30 korrik 2020

Kryetari i Këshillit Drejtues  
Dr. Pleurat Sejdiu, mr. sci

